| **Shërbimi** | **Përshkrimi i shërbimi** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total për shërbim(*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total (Shërbimet)** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |

| | |
|---|---|
| **Datë ________________** | |

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Tabela nr. 1**

| Nr. | Përshkrimi i mjeteve | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| **1.** | Mjet teknologjik për transportimin e mbetjeve urbane | copë | 1 (një) |
| **2.** | Automjet teknologjik/Autobot me thithje për pastrimin e gropës septike | copë | 1 (një) |
| **3.** | Autobot uji për furnizimin me ujë të godinës dhe/ose për vaditje | copë | 1 (një) |

## 1. <u>MJET TEKNOLOGJIK PËR TRANSPORTIMIN E MBETJEVE URBANE</u>

Kjo makinë teknologjike është e nevojshme për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane të godinës "Zyrat modulare për agjencitë doganore".

Automjeti të ketë këto specifikime teknike:

- të ketë aftësi ngjeshëse;
- të jetë me ngarkim fundor ose anësor;
- të ketë kapacitet mbajtës jo më të vogël se 1 ton;

## 2. <u>AUTOMJET TEKNOLOGJIK/AUTOBOT ME THITHJE PËR PASTRIMIN E GROPËS SEPTIKE</u>

Gropa septike është si një pus i cili shërben për mbledhjen e ujërave të zeza (depozitim) dhe në kushtet kur kjo e fundit nuk ka kanalizim për shkarkimin e mbetjeve (fekale) është i nevojshëm pastrami periodik i saj (një here në muaj) nëpërmjet autobotit me proces thithës dhe procedohet nga sipër.

Autoboti përbëhet nga një depo e ujërave të zeza dhe një pompë vakumi, e cila përdoret për të pompuar, transferuar ose asgjësuar ujërat e zeza nga gropa septike.

Autoboti të ketë këto veçori:

- të ketë veti Vetë-mbushëse, vetë-shkarkuese;
- të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 1000 litra.

Pastrimi i gropes septike do të përfshijë:

- Hapjen e kapakut;
- Thithjen me autobot të ujrave të zeza;
- Zhbllokimin e kanalizimit në rastet e nevojshme;
- Dezinfektimin me klor;
- Mbylljen e kapakut;
- Transportin e ujërave  të zeza për në pikën e riciklimit.

Ky automjet është parë i nevojshëm të kërkohet nga A.K bazuar edhe në rekomandimet e dhëna në Relacionin Teknik "Për blerje dhe vendosje grope septike përnevojat e zyrave të reja modulare" *(të cilin do ta gjeni bashkëlidhur dokumenteve të tenderit).*

## 4.<u>AUTOBOT UJI PËR FURNIZIMIN ME UJË TË GODINËS DHE/OSE PËR VADITJE</u>

Ky automjet është parë i nevojshëm të kërkohet nga A.K në rast se në godinën "Zyrat modulare për asgjnecitë doganore" do të ketë problem të mungesës së furnzimit të godinës me ujë si dhe nëse OE e sheh të arsyeshme të përdoret edhe për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta përreth godinës, pasi në Termat e references Autoriteti Kontraktor e ka lënë opsionale mënyrën e vaditjes me autobot ose markush/tub dore.

Autoboti të ketë këto veçori:

- të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 1000 litra.

**Tabela nr. 2**

| **Nr.** | **Përshkrimi i pajisjeve** | **Njësia** | **Sasia** |
|---|---|---|---|
| **1.** | Platformë ngritëse për pastrime në lartësi | copë | 1 (një) |
| **2.** | Pompë profesionale dezinfektimi | copë | 1 (një) |
| **3.** | Makinë korrëse bari | copë | 1 (një) |
| **4.** | Sondë teknologjike me pompë vakumi dhe presioni | copë | 1 (një) |

1. **Platformë ngritëse për pastrime në lartësi,** me lartësi jo më pak se 7 metra dhe peshëmbajtje e platformës minimumi 100 kg, e cila vjen në ndihmë për mbajtjen e punëtorëve për kryerjen e shërbimit sikurse është pastrimi i fasadave të jashtme të godinës.

2. **Pompë profesionale dezinfektimi të thjeshtë krahu**, sipas nevojave specifike të ambienteve, nëpërmjet mënyrave si psh:
   - me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, që garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulim 100% të ambientit (kryesisht ambiente të vogla zyrash, tualetesh etj ), me pajisjet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj);
   - me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave tëvogla të preparatit dhe mbulim 100% të ambientit (kryesisht për spërkatje sipërfaqesh dyshemeje, korridore muresh të jashtme etj) me mjetet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj);
   - me spërkatje mjegulluese në të nxehtë, minimumi 5 metra largësi (kryesisht për sipërfaqe të jashtme, ballkone, sheshe pushimi, holle të hapura etj) me pajisjet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj).

3. **Makinë korrëse bari**, teh prej çeliku i mprehtë për prerje të lehtë të barit, të jetë elektrike ose me karburant, për përdorim profesional.

4. **Sondë teknologjike me pompë vakumi dhe presioni** e cila shërben për hapjen e tubacioneve në rast bllokimi dhe larjen periodike të tyre.

**Materialet e nevojshme të pastrimit që do të nevojiten për kryerjen e këtij shërbimi, janë të listuara në tabelën e mëposhtme:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1. | Letër higjenike | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 2. | Letër për fshirje duarsh | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 3. | Shtupë/leckë për pastrimin e dyshemesë | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 4. | Pecetë/leckë për pastrim universal (për xhama, pluhura, mobilje, dyer etj). | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 5. | Kovë plastike për larje dyshemeje | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 6. | Lopatë plastike për mbledhje mbeturinash me bisht të gjatë | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 7. | Fshesë pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 8. | Bishta për fshesa dhe shtupa | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 9. | Solucion larës pllakash, dyshemeje, parketi etj. | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 10. | Sapun i lëngshëm/likuid për larje duarsh | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 11. | Qese mbeturinash 70x85 cm, 70 litra | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 12. | Qese mbeturinash 100x75 cm, 100 litra | Pako | Sipas nevojës të A.K |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 13. | Solucion dezifektues/higjenizues/zbardhues banjosh | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 14. | Furçë për pastrimin e WC-ve | Copë | 30 |
| 15. | Doreza pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 16. | Sfungjer pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 17. | Solucion për pastrimin e mobiljeve, dyerve etj. | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 18. | Solucion për larjen e xhamave | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 19. | Kosh për mbeturina letre, me pedale, pranë zonës së lavamaneve. | Copë | 10 |
| 20. | Kosh mbeturinash për WC, në zonën e tualeteve brenda | Copë | 30 |
| 21. | Kosh mbeturinash për zyra | Copë | 80 |
| 22. | Mbajtëse letre higjenike | Copë | 30 |
| 23. | Mbajtëse letre për duart | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 24. | Mbajtëse për sapun të lëngshëm | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 25. | Uniforma për personelin e pastrimit | Copë | Sipas nevojës të A.K |

*Shënim: Materialet e pastrimit duhet të jenë shumë cilësore, të cilat nuk duhet të jenë gërryes por pastrues dhe higjenizues.*

**<u>Specifikimet teknike të materialeve të pastrimit :</u>**

1. **Letër higjenike** në pako, jo më pak se 10 rula (me 2 shtresa, e butë, me aromë, me këputje, 100% celulozë). Letra të ketë ngjyrë të bardhë. Duhet që produktet e brendit të kenë certifikatë kualiteti ku të përshkruhet që materiali është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

2. **Letër për fshirje duarsh** në pako me paketim jo më pak se 270 fije, me dy shtresa, ngjyrë e bardhë, që vendosen në aparatet e tyre, të jetë cilësore. Produkti duhet të jetë i certifikuar me certifikatë kualiteti ku të përshkruhet që është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

3. **Shtupë/leckëpër pastrimin e dyshemesë** me material mikrofibër , të jetë e plotë 100% ekologjike. Fijet të jenë në shirita me përmasa 25x4 cm+/- 2 cm.

4. **Pecetë/leckë për pastrim universal** (xhama, pluhura, mobilje, dyer etj) me material mikrofibër (tip peshqiri) e butë dhe e aftë të fshijë njollat me lehtësi, me kualitet cilësor.

5. **Kovë plastike për larje dyshemeje**, me pajisje të montuar në kovë që bën shtrydhje të shtupës. Material rezistent dhe praktik, me kapacitet 15-17 litra.

6. **Lopatë plastike për mbledhje mbeturinash** me bisht të gjatë, material plastik, i lehtë dhe praktik për të pastruar.

7. **Fshesë pastrimi,** e pajisur me bisht të gjatë, me fije të holla e të gjata që nuk këputen plastikë e fortë.

8. **Bishta për fshesa dhe shtupa**, material cilësor dhe rezistent të përshtatet lehtë në fshesë dhe shtupë.

9. **Solucion larës pllakash, dyshemeje**, të jetë sa më i koncentruar (1-200 me ujë), të lërë aromë të lehtë pas larjes, e të mos lërë njolla në pllaka e parkete. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë prodhim me standarte të EU dhe i certifikuar sipas standarteve EU. Përmasat nga 1 -10 litra. Të jenë linja profesionale . Niveli i PH- (8+/- 5%).

10. **Sapun i lëngshëm për larje duarsh,** ambalazhimi të jetë në bidona plastike nga 3-5 litra. Të jetë i certifikuar, të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë antibakterial, me aftësi shkumuese të lartë, të ketë aromë të lehtë, i butë për lëkurën dhe i testuar dermatologjikisht. Niveli i PH (6+/-5%).

11. **Qese mbeturinash** me përmasa 70x85 cm, me kapacitet 70 litra, qeset të jenë plastike, rezistente dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje/copë.

12. **Qese mbeturinash** me përmasa 100x75 cm, me kapacitet 100 litra, qeset të jenë plastike, rezistente dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje/copë.

13. **Solucion dezifektues/higjenizues/zbardhues banjosh**, për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve, veshjeve porcelani, hidrosanitareve. Të heqë pikat e bardha të ujit. Të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim minimum nga 1-150 në 1-200 me ujë. Masat nga 1-10 litra. Të jenë linja profesionale. Niveli i PH – (1-2).

14. **Furçë për pastrimin e WC-ve**, e përbërë nga material rezistent plastik, me kokë me fije plastike të forta dhe mbajtëse plastike, lehtësisht e përdorshme dhe e pastrueshme.

15. **Doreza pastrimi**, material latex, të trasha, të gjata, me përmasë Medium, që përdoren gjatë larjes së tualeteve apo ambienteve të tjera të godinës.

16. **Sfungjer pastrimi,** e përbërë nga 2 anë, njëra anë e butë për të larë dhe ana tjetër me rrjetë për të fërkuar dhe zhdukur të gjitha sipërfaqet e papastra duke përfshirë ato më delikate. Nuk lë njollë.

17. **Solucion për pastrimin e mobiljeve, dyerveetj**, në formë spray, me përmasa 500 ml, të jetë prodhim me standartet të EU dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë.Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8-9).

18. **Solucion për larjen e xhamave,** në formë spray, me përmasa 500-750 ml, të jetë prodhim me standartet të EU dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8.5-9).

19. **Kosh për mbeturina letre, pranë zonës së lavamanëve** me pedale, të cilët do të vendosen në zonën para tualete, ku ndodhen lavamanët me qëllim për të hedhur letrat që do të përdoren për fshirjen e duarve. Material plastik rezistent, me kapak, me kapacitet mbi 50 litra.

20. **Kosh mbeturinash për WC**, **në zonën e tualeteve brenda,** me ose pa kapak, material plastik rezistent, me kapacitet 6-10 litra.

21. **Kosh mbeturinash për zyra**, me rrjetë metalike, rezistente, rrethor, ngjyrë e zezë, me kapacitet 16-20 litra.

22. **Mbajtëse letre higjenike**, që montohet në mur, material inoksi, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. E përshtatshme për të gjitha madhësitë standarte të letrës higjenike.

23. **Mbajtëse letre për duart**, që montohet në mur, material inoksi ose plastik, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. E përshtatshme për të gjitha madhësitë standarte të letrës së duarve. Me kapacitet jo më pak se 500 letra.

24. **Mbajtëse për sapun të lëngshëm**, që montohet në mur, material plastik ose inoksi, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. Me kapacitet 1000 ml.

25. **Uniforma për personelin e pastrimit**, të jenë material pambuku, me kopsa, të përshtatshme për dimër dhe verë, me përmasa standarte.

**Listë e materialeve hidraulike të nevojshme që do të përdoren sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas tabelës më poshtë:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Set grup lavamani | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 2 | Tuba fleksibël | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 3 | Mishelatorë | Copë | Sipas nevojës së A.K |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Saraçineskë | Cope | Sipas nevojës së A.K |
| 5 | Piletë + Shkarkues | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 6 | Galixhantë | Cope | Sipas nevojës së A.K |
| 7 | Gomina për grupe WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 8 | Kasetë shkarkimi WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 9 | Nenjëse plastike WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 10 | Bolierë të ujit të ngrohtë sanitary | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 11 | WC porcelani | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 12. | Lavamanë porcelani | Copë | Sipas nevojës së A.K |

**Specifikimet teknike të materialeve hidraulike:**

1. **Set Grup lavamani, të jetë i montueshëm në lavaman,** në formë cilindrike prej inoksi.
2. **Tuba fleksibël** M Ø 3/8, të jenë material PVC i cilësisë së lartë, që të përdoren për furnizim me ujë. Lavamanët lidhen me sistemin e furnizimit me ujë me anë të dy tubave fleksibel me gjatësi 30 - 50 cm dhe diameter ½, të cilët bëjnë lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me ujë të ngrohtë dhe ujit të zakonshëm. Në vendin e lidhjes së rubinetit me lavamanin duhet të vendosen gominat e përshtatshme, për të mos bërë lejimin e rrjedhjes së ujit.
3. **Mishelator lavamani** për instalim në lavaman, Prurja 3 l/min. Buton me shtypje dhe pulsant në bronx të kromuar. Kokë ndërrimi të valvulës së brendshme. Pjeset e brendshme dhe pjesët e tjeta të ndryeshme të jenë rezistente ndaj ndryshkjes dhe antikalcium. Sistem kundër bllokimit.
4. **Saraçineska**t janë pajisje të veçanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Me anë të saraçineskave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që i jepet pjesës tjetër të tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saraçineskat mund të jenë me material bronxi, gize. Ato janë të tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me fllanxha. Saraçineskat sipas mënyrës së bashkimit me tubat i ndajmë në lloje: a) me fllanxhë dhe b) me fileto. Saraçineskat përbëhen prej pjesëve të mëposhtme: Trupi cilindrik prej gize ose bronxi. Në këtë trup duhet të fiksohen fllanxhat përkatëse, të cilat shërbejnë për lidhjen e saraçineskës me tubacionin e rrjetit. Disku ose sfera i cili duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e saraçineskës. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj. Volanti apo leva, e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut nëpërmjet lëvizjes vertikale rrotulluese. Kapaku i saraçineskës, i cili lidhet me anë të bullonave dhe dadove me trupin cilindrik të saraçineskës ose me filetim.

5. **Piletë + shkarkues** fleksibël është elementi kryesor i cili realizon shkarkimin e ujërave Materiali përbërës është PP(polipropilen) i cili ofron rezistencë të lartë ndaj kimikateve dhe veti të shkëlqyera izoluese. Përmasa e lidhjes me piletën është 1x1/2 me një diameter shkarkimi 32 mm.

6. **Galixhant i kasetës,** realizon sistemin e plotë të qarkullimit të ujit në kasetë. Kur arrihet niveli i ujit ky mekanizëm mbyll valvulën që furnizon kasetën. Furnizimi me ujë realizohet vertikalisht me diametër 3/8 dhe adaptor 1/2.
7. **Gomina për grupe WC,** është një aksesor hidraulik i cili shërben për të lidhur kasetën plastike me ËC-në. Materiali i gomës i jep fleksibilitet, një izolim perfekt dhe rezistencë të lartë.Ngjyra e bardhë, materiali gomë.
8. **Kasetë WC,** materiali porcelan, të jetë me mekanizëm. Lartësia 80 cm.
9. **Ndenjëse plastike e WC-së,** material plastikë cilësore dhe rezistente ndaj thyerjeve, ngjyra e bardhë.
10. **Bolierë të ujit të ngrohtë sanitar.** Uji i ngrohtë sanitar është i kompozuar të realizohet prej prodhuesit të energjisë termike që në rastin tonë do të jenë bolirët elektrik si dhe tubacionet e pajisjes për furnizimin dhe rregullimin e ujit. Madhësia e tij është kalkuluar në fuksion të nevojave për ujë sanitar dhe karakteristikat e tij duhet të jenë përcaktuar qartë në çertifikatën e kualitetit të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Karakteristikat teknike kryesore janë praqitur më poshtë:
    *Tipi:* Boiler horizontal i termoizoluar me shkëmbyes inoksi të ç'montueshem;
    *Izolimi:* Shtresë fleksibile shkumë polyuretan 50 mm trashesi;
    *Veshja e jashtme:* Çeliku me karbon, i mbrojtur me një shtresë epoxidi në ngjyrë të bardhë e polimerizuar;
    *Mbrojtja:* Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magneze e thjeshte;
    *Kapaciteti :* 20 lit – 60 lit, Pmax 8 bar, Tmax 95 0C;
    *Kondita e punës :* Pmax 8 bar, Tmax 95 0C.
11. **WC për tualet**, me montim në tokë ose në mur, me përmasa të ëc-ve aktuale, materiali porcelan cilësor dhe rezistent ndaj thyerjeve, ngjyra e bardhë.

12. **Lavamanë me kolonë për tualet,** materiali porcelan, i cili ofron qëndrueshmëri dhe lehtësi pastrami, ngjyra e bardhë. Përmasat e lavamanit do të jenë sipas përmasave të lavamanëve aktualë që gjenden në tualete.

**Listë e materialeve elektrike të nevojshme që do të përdoren sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas tabelës më poshtë:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1. | Çelësa elektrik | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 2. | Suport prizash | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 3. | Kuti shpërndarje elektrike | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 4. | Priza standarte | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 5. | Panele TU | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 6. | Nriçues Led | copë | Sipas nevojës së A.K |

**<u>Specifikimet teknike të materialeve elektrike:</u>**

1. **Çelësat elektrikë,** përdoren për të komanduar energjinë elektrike duke fikur ose ndezur një pajisje ose ndriçues të montuar në seri me çelësin, në tension deri në 250 V. Çelësi elektrik të jetë pulsant i thjeshtë, material plastik, 10 A, 1 M, i bardhë. Lartësia e çelësave elektrikë është 110 cm nga dyshemeja. Numri i moduleve sipas atyre që janë ekzsistues në godinë.
2. **Suport prizash,** material plastik, i qëndrueshëm, i cili përdoret për të fiksuar celësat, prizat dhe tapat falso. Në këtë support mund të vendosen 3 Module. Suporti ka të përfshirë vidat. Numri i moduleve sipas atyre që janë ekzsistues në godinë.

3. **Kuti shpërndarje elektrike,** tipi: kuti automati, material plastik, cilësor, të ketë 3 apo 4 module jashtë murit, ngjyra e bardhë.
4. **Priza standarte,** tip shuko, e përbërë nga 2 module, 2P+T, 16A, 250 V, ngjyrë e bardhë. Thellësia 4cm; Materiali: Plastik/bakër; Gjerësia 4.3cm; Gjatësia 4.3 cm.
5. **Panelet e Tensionit të Ulët**, shërbejnë për të garantuar nivelin maksimal të kualitetit dhe performancës dhe të përmbushin kërkesat e standartit IEC Standard: 60439. Standarti IEC 60439-1 aplikohet në ndarësit dhe në montimin e paisjeve të kontrollit për tension jo më të madh se 1000 V, në rrymë alternative dhe frekuencë jo më të madhe se 1000 Hz, ose 1500 V në DC. Ky standart është gjithashtu i aplikueshëm për të gjitha montimet që përdoren për lidhjet me gjenerator, transmetim, shpërndarje dhe shndërrim të energjisë elektrike dhe për kontroll të paisjeve të konsumit të energjisë elektrike. Për të garantuar instalimin gjatë ciklit të jetëgjatësisë së panelit, sistemi i instalimit dhe paisjet duhet të ushqehen nga i njëjti furnizues.

   Specifikimet tekniko-fizike të panelit:

   Lartësia: ≤ 2000m
   Temperatura e ambjentit: standarte
   Temperatura mesatare e ambjentit 35°C
   Lageshtia relative: standate (80% - 35°C)
   Ambjenti klimatik: standard

   Specifikimet Elektrike
   Tensioni Nominal: deri ne 1000 V
   Frekuenca: 50 Hz
   Rryma Nominale: [400] A
   Rrymat e Lidhjes së Shkurter: 85 kA
   Sistemi i tokëzimit: [TNS]

   Specifikimet konstruktive të panelit
   Mbështjellësja:
   Shkalla e mbrojtjes IP: [55]
   Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK: [10]
   Ngjyra: standart RAL 9001
   Dera: me bllokim me çeles
   Gjëresia: 800 mm
   Lartesia: 2000 mm
   Thellesia: 300 mm

   Hapesirë e llogaritur:
   Hapësirë e lire 30 %

6. **Ndriçues Panel LED**, të vendosur në zyra, të jenë inkaso, forma rrethore dhe me aksesorë jashtë tavanit, 60x60cm, 40Ë, 3600 lm, 4000K, IP40.
   Ndriçues panel Led, të vendosur në tualete, forma rrethore, 20Ë, 2000 lm, 4000 K IP44.

   Ndriçues emergjence evakuimi me tregues dalje EXIT, LED 8Ë, me autonomi 3 orë, IP67 me bateri Ni-Cd.

**Shënim:** *OE duhet t'i referohet në çdo rast Projektit të plotë të godinës për ndërtimin e zyrave modulare (projekti arkitektonik, hidroteknik; elektrik, konstruktiv, MZSH, etj) dhe Projektit « Për gropën septike».*

**Shtojca 6**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:** Mirëmbajtje e objektit "Zyrat modulare për agjensitë doganore".

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

| Shërbimet | Përshkrimi | Vendi i ekzekutimit | Afati i ekzekutimit |
|---|---|---|---|
| Sipas Termave të referencës | Mirëmbajtje e objektit "Zyrat modulare për agjensitë doganore" | Pranë zonës së ish-Kantierit Detar, porti Durrës | 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës |
| | | | Pagesa ndaj OE do të behet mbi bazën e faturave periodike mujore. |

**Shtojca 7**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCES**

## I. HYRJE

Shoqëria "Albanian Seaports Development Company" sh.a, synon të realizojë me anë të një Kontrate Shërbimi, mirëmbajtjen e objektit *"Zyrat modulare për agjencitë doganore",* me vendndodhje, pranë zones së ish-Kantierit Detar, porti Durrës, me afat ekzekutimi 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Këtë objekt, shoqëria ASDC e ka marrë në administrim të saj nga Autoriteti Portual Durrës (si investitor/pronar i godinës), me anë të Protokollit të Dorëzimit nr. 257/2 prot, datë 25.10.2023, me qëllim gjenerimin e të ardhurave të saj nga dhënia me qira e këtij objekti.

## II. PËRMBAJTJA E ASETEVE

1. **Zyrat modulare për agjencitë doganore**

Përbëjnë, tërësinë e godinës në të cilën janë akomoduar dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar agjensitë doganore, institucione financiare etj.

### 1.1 Objekti/Godina e zyrave modulare

1.1.1 Është e përbërë nga një strukturë me konstruksion metalik, e ndarë në module me qëllim të shfrytëzimit ekonomik "ambiente për zyra"(*bashkëlidhur për reference projekti i plotë i godinës).* Kjo godinë ndër të tjera ka dhe këto komponentë:

*1.2 Ambientet e përbashkëta (shkallë, korridore, tualete)*

Janë hapësira publike të cilat janë në përdorim të të gjithë perosnelit që është akomoduar në këtë godinë.

*1.3 Gropa septike*

1.3.1 Gropa septike është një depozitë e cila shërben për grumbullimin e ujërave të zezave instaluar me vendndodhje mbrapa godinës "Zyrat modulare për agjencitë doganore" (në jug të godinës), me kapacitet/volum prej 30.000 (tridhjetë mijë) litra. *(bashkëlidhur për reference projekti i gropës septike).*

*1.4 Sipërfaqet e gjelberuara dhe parkingu.*

1.4.1 Përreth godinës ndodhen zona të dedikuara (sheshe) për Parking dhe sipërfaqe të cilat shërbejnë për gjelbërim *(bashkëlidhur për reference projekti i plotë i godinës).*

*1.5 Kabina elektrike*

E cila shërben për të furnizuar të gjithë objektin me energji elektrike.

## III. TERMA TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

### <u>3.1 TERMA TE PERGJITHSHME</u>

**3.1.1 Shërbimi i mirëmbajtjes të zyrave modulare kërkohet të kryhet:**

- Nga një Operator i cili ka experiencë të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit;
- Në përputhje me standartet cilësore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të zbatuara sot njëkohësisht duke respektuar standartet dhe legjislacionin/rregullat e shtetit shqiptar për këtë qëllim;
- Operatori do të marrë përsipër të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes të zyravemodulare, ashtu sic përcaktohet në këto Terma Reference (TeR) dhe në specifikimet teknike.

**3.1.2 Përzgjedhja e Operatorit**

Operatori do të përzgjidhet nëpërmjet konkurrimit publik, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin public në fuqi.

**3.1.3 Kohëzgjatja e Zbatimit të Kontratës**

Kontrata e shërbimit për mirëmbajtjen e objektit "Zyrat modulare për agjencitë doganore", do të lidhet ndërmjet palëve kontraktore: Shoqërisë ASDC (në clësinë e Autoritetit Kontraktor) dhe Operatorit të Mirëmbajtjes (në cilësinë e Kontraktorit), për një afat prej 12(dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

**3.2 PËRKUFIZIME**

**3.2.1 Operatori i Mirëmbajtjes.**

Nënkupton operatorin e përzgjedhur nga ASDC sipas procedurave të përcaktuara ligjore, për të ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së objektit "Zyrat modulare për agjencitë doganore".

**3.2.2 Mirëmbajtje e Aseteve të godinës**

Përfshin shërbimet e kërkuara, parandaluese ose riparuese, për të garantuar një funksionim normal dhe pa ndërprerje të mbarëvajtjes së punës në këtë godinë.

**3.2.3 Program Mirëmbajtje**

Nënkupton një program të planifikimit mbi zërat e shërbimeve që kërkohen të kryhen nga A.K për mirëmbajtjen e objektit "Zyrat modulare për agjencitë doganore", që përfshin:

- Raportimin e nevojës/kryerjen e mirëmbajtjes parandaluese.;
- Raportimin e nevojës/kryerjen e mirëmbajtjes riparuese;
- Regjistrimin e ndërhyrjeve mirëmbajtëse të kryera sipas këtij programi.

**Tabela nr. 1 – Programi i mirëmbajtjes**

| Nr.rendor | Përshkrimi i shërbimit | Njësia | Sasia | Frekuenca (here në vit) |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **Shërbimi i pastrimit të godinës.** | | | |
| a. | Fshirja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së zyrave | m2 | 1273 | Çdo ditë |
| b. | Fshirja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së korridorreve | m2 | 915 | Çdo ditë |
| c. | Fshirja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së tualeteve dhe të gjitha zonave të vështira për tu arritur | m2 | 170 | Çdo ditë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| d. | Fshirja me mjete të zakonshme pastrimi e tarracave ( ballkonave) të godinës | m2 | 282 | Çdo ditë |
| e. | Fshirja me mjete të zakonshme pastrimi e shesheve përreth godinës (parkingu). | m2 | 2800 | Çdo ditë |
| f. | Larja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së zyrave | m2 | 1273 | Çdo ditë |
| g. | Larja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së korridorreve | m2 | 915 | Çdo ditë |
| h. | Larja me mjete të zakonshme pastrimi e dyshemesë së tualeteve, mureve të tualeteve dhe të gjitha zonave të vështira për tu arritur, e ËC-ve, lavamanëve dhe pjesëve përreth tyre si dhe shkëlqimi i elementëve të porcelanit dhe inoksit | m2 | 170 | Çdo ditë |
| i. | Larja e dritareve të tualeteve. | copë | 12 | Çdo ditë |
| j. | Larja me mjete të zakonshme pastrimi e tarracave ( ballkonave) të godinës | m2 | 282 | Çdo ditë |
| k. | Larje e fasadës së xhamave të godinës nga Brenda dhe jashtë | m2 | 500 | Njëherë në muaj |
| i. | Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave të plehrave (për tualet, zyra, korridore etj) | copë | 125 | Çdo ditë |
| m. | Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjenike, letër duarsh, sapun i lëngshëm duarsh) | tualet e | 12 | Çdo ditë |
| n. | Pastrimi i derës hyrëse të godinës, dyerve të emergjencave dhe dyerve të ambienteve të brendshme ( zyra, tualete, dhoma e serverave etj) | copë | 92 | Çdo ditë |
| o. | Shërbim evadimi i mbetjeve urbane | kg | 100 | Çdo ditë |
| p. | Shërbimi i Dezinfektimit, periodik të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës | m2 | 2655 | Dy herë në vit |
| **2** | **Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit hidrik të godinës.** | | | |
| a. | Mirëmbajtja e rrjetit të brendshëm hidrik të godinës (zëvendësim pjesësh, F.V set grup lavamani, tubash fleksibël, mishelatorë, saraçineska, piletë + shkarkues, galixhant, gomina për grupe WC, WC, kasetë WC porcelani + rezervuar (flash box) + ndenjëse plastike e WC-ve, bolierë të ujit të ngrohtë sanitar, lavamanë etj). | tualet e | 10 | Sipas nevojës |
| b. | Mirëmbajtja e tubacioneve të tualeteve dhe kanalizimeve të kullimit si dhe larja e tyre me mjet teknologjik (sondë) | ml | 120 | Sipas nevojës |
| c. | Mirembajtja e tubacioneve të shkarkimit të ujërave të shiut. | ml | 100 | Sipas nevojës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3** | **Pastrim periodic i gropes septike.** | | | |
| a. | Kontroll dhe heqja e mbeturinave nga gropa septike. | l | 30000 | Njëherë në muaj |
| **4** | **Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik të godinës.** | | | |
| a. | Mirëmbajtja e rrjetit të brendshëm të shpërndarjes me energji elektrike (çelsa, priza, kuti, suporte etj). | set | 1 | Sipas nevojës |
| b. | Mirëmbajtja e rrjetit me energji elektrike të Paneleve TU | copë | 1 | Sipas nevojës |
| c. | Mirëmbajtje e ndërrim i ndriçuesve Led 20-50W | copë | 32 | Sipas nevojës |
| **5** | **Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbërta të ambientit përreth godinës.** | | | |
| a. | Kositja e rregullt e të gjithë sipërfaqes me bar në sheshin përreth godinës | m2 | 287 | Dy herë në muaj |
| b. | Sigurimi i nevojshëm i vaditjes së duhur për të gjitha zonat e gjelbërta | m2 | 287 | Dy herë në javë |
| c. | Mbjellje, zëvendësim i luleve për ambientet e jashtme, mëllaga, cikalmen etj | m2 | 287 | Dy herë në vit |

### 3.2.4 Programi i mirëmbajtjes së operatorit

Duke respektuar kërkesat e shoqërisë ASDC, të shprehura në këtë dokument, është në detyrimin e Operatorit të mirëmbajtjes të paraqesë një Program Mirëmbajtje në fund të çdo muaji (kusht i domosdoshëm) pranë A.K.

### 3.2. 5 Rregullore e Veprimtarisë së Mirëmbajtjes së godinës

Nënkupton tërësinë e procedurave të miratuara nga palët, për të garantuar kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes sipas:

- Normave, standarteve, proçedurave dhe praktikave më të mira të rekomanduara.

- Në respektim të plotë të kërkesave të funksionimit të përcaktuara bazuar në Projektin e plotë të godinës

- Në respektim të kërkesave dhe rregullave lidhur me sigurinë e mos shkaktimit të dëmeve gjatë kryerjes së veprimtarisë mirëmbajtëse.

- Në zbatim të rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin e shtetit Shqiptar dhe atij ndërkombetar, lidhur me garantimin e sigurisë në punë gjatë kryerjes së veprimtarisë mirëmbajtëse.

Rregullore e cila gjëndet në detyrimin e operatorit mirëmbajtës për tu zbatuar sipas kësaj marëveshje.

### 3.2.6 Mirëmbajtje Parandaluese "MP"

Është përcaktuar si pjesë e aktiviteteve të mirëmbajtjes së godinës, që kryhet nga operatori sipas një programi të paraplanifikuar dhe që gjëndet në detyrimin e tij për tu kryer sipas kësaj marrëvëshje.

Këto aktivitete janë shërbime që kërkohen të kryhen mbi baza kohore periodike, ditore, javore, mujore apo vjetore ose të lidhur sipas orëve të punës së shfrytëzimit, me qëllim për të parandaluar ose vonuar amortizimin e komponentëve të godinës.

Veprimtaria "MP" përfshin: pastrimin, kontrollin, shqyrtimin, rregullimin, dhe testimet e kryera.

### 3.2.7 Mirëmbajtje Riparuese "MR"

Është përcaktuar si një pjesë e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe që është në detyrimin e operatorit për tu kryer sipas kësaj marrëveshje.

Këto aktivitete janë shërbime që kryhen mbi baza të raportimeve për prishje apo dëmtime të Asetit apo pajisjeve, me pasoja ndalimin e përkohshëm të punës së tyre.

Ndërhyrja Riparuese "MR", përfaqeson një ndërhyrje mirëmbajtëse të menjëhereshme, që nënkupton: Kontrollin, shqyrtimin, ndërrimin e pajisjeve, pjesëve apo përbërësve të veçantë, rregullimin, testimin e Asetit /pajisjes dhe garantimin e mirëfunksionimit të tij.

Këto aktivitete kanë për qëllim riparimin e Aseteve dhe kthimin e tyre për shfrytëzim në një kohë sa më të shkurtër.

### 3.2.8 Zëvendësim_ZV

Nënkupton ndërrimin e instalimeve apo pjesë të tyre si dhe pajisjeve apo pjesëve të një Aseti /pajisje, për të kompensuar vjetërimin ose konsumin e tyre, si dhe për të qenë të përditësuara.

Një zëvendësim i tillë do të garantonte mirëfunksionimin në vijueshmëri të Aseteve të Infrastruktures Energjitike, hidraulike, etj.

Një instalim, pjesë e tij, pajisje, etj.., zëvendësohet vetëm kur ajo nuk mund të jetë ekonomikisht e rehabilituar.

### 3.2.8 Inspektim

Janë veprime për të realizuar kontrolle të rregullta dhe prova lidhur me mirëfunksionimin e Aseteve.

### 3.2.9 Suportet dhe garancitë e Prodhuesit

Janë "Mbështetje teknike" me anë të së cilës prodhuesit ose distributorët e autorizuar prej tij, angazhohen të mbështesin brenda afateve të vlefshmerisë së marrëveshjeve, çdo problematikë të ndeshur gjatë shfrytëzimit të Aseteve, kjo nënkupton gjithashtu:

- Zëvendësimin e pjesshëm apo të plotë, pa pagesë, të pajisjeve (apo pjesëve) brenda periudhës së garancisë së tyre.

## 3.3 <u>OBJEKTIVAT E TERMAVE TË REFERENCËS</u>

Autoriteti Kontraktor kërkon që me anë të një Kontrate Shërbimi, t'ja kalojë kryerjen e të gjitha shërbimeve të lidhura me riparimin dhe mirëmbajtjen e objektit “Zyrat modulare për

agjencië doganore", një operatori privat, duke siguruar në këtë mënyrë :

3.3.1 Një Operator të vetëm, përgjegjës për Mirëmbajtjen dhe Riparimin, i cili, do të jetë përgjegjësi i vetëm për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për Mirëmbajtjen dhe Riparimin e Aseteve, përfshirë aksesorë e instalime që shoqërojnë funksionimin e tyre, i cili do të programojë, planifikojë, menaxhojë e realizojë, të gjitha ndërhyrjet e nevojshme të lidhura me gatishmërinë, për ti mbajtur ato në gjendje pune e funksionimi sa më të mirë .

3.3.2 Mbështetja nga një Operator Mirëmbajtjes i specializuar.

Autoriteti Kontraktor do të mbështetet në veprimtarinë e tij nga një Operator Mirëmbajtës me përvojë dhe kompetent që do ti përgjigjet të gjitha nevojave për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të Aseteve, pajisjeve etj me qëllim që ato të jenë gjithnjë moderne dhe të përditësuara.

3.3.3 Masa dhe cilësia e ndërhyrjeve mirëmbajtese te përshtatëshme

Masa dhe cilësia e ndërhyrjeve mirëmbajtëse do të jetë e përshtatshme, organizimi dhe menaxhimi i veprimtarisë mirëmbajtëse do të jetë efikas, duke garantuar funksionimin normal e në çdo kohë të Asetit.

3.3.4 Ndërhyrjet mirëmbajtëse të organizuara

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes do të jenë të organizuara, të kontrolluara e me fleksibilitet, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

### 3.4 DETYRAT E OPERATORIT TË MIRËMBAJTJES

Operatori i Mirëmbajtjes, merr përsipër të organizojë dhe menaxhojë kryerjen e të gjitha sherbimeve të lidhura me mirëmbajtjen dhe riparimin e Aseteve, pajisjeve të godinës sipas kushteve të përcaktuara në termat e referencës .

3.4.1 Vendi ku do të kryhet shërbimi për mirëmbajtjen e objektit

Veprimtaria e Operatorit të Mirëmbajtjes, do të zhvillohet në godinën e re"Zyrat modulare për agjencitë doganore" të investuar nga Autoriteti Portual Durrës, me vendnodhje pranë ish-Kantierit Detar, porti Durrës.

3.4.2 Pajisjet, veglat e punës, produktet

Operatori i Mirëmbajtjes, me qëllim për të përmbushur detyrimet sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike, merr përsipër të sigurojë me shpenzimet e tij mjetet, pajisjet, produktet/mallrat, veglat e nevojshme të punës për kontrollin, ekzaminimin, riparimin dhe testimin e Aseteve, pajisjeve që i janë caktuar atij për mirëmbajtje sipas kësaj marëveshje.
Mjetet, Pajisjet, veglat e punës,në përfundim të zbatimit të kontratës, mbeten pronë e Operatorit privat.

### 3.4.3 Personel teknik i kualifikuar

Operatori i Mirëmbajtjes, me qëllim që të përmbushë detyrimet e tij, merr përsipër të sigurojë personel të mjaftueshëm teknik, të cilët duhet të jenë të kualifikuar në përputhje me specifikën e objektit të veprimtarisë mirëmbajtëse.

### 3.4.4 Ambientet e Punës

Autoriteti Kontraktor, me qellim krijimin e kushteve normale për zhvillimin e veprimtarisë mirëmbajtëse të operatorit, vë në dispozicion të tij, ambiente pune me hapsirë të mjaftueshme me qëllim për tu përdorur prej tij si zyra dhe oficinë për të përmbushur detyrimet sipas TER dhe specifikimeve teknike.

### 3.4.5 Evidentimi, Regjistrimi dhe administrimi i të dhënave

Operatori, në përmbushjetë detyrimeve te tij, merr përsipër :

- Të administrojë dokumentacionin teknik që ka të bëjë me objektin e veprimtarisë së mirëmbajtjes.

- Të mbajë në evidencë ndryshimet teknike të mundeshme të Asetit e pajisjeve, të pësuara gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të operacioneve të mirëmbajtjes, duke i perditësuar këto dokumenta në vazhdimësi si dhe;

- Të mbajë regjistrime të plota e të sakta për të gjithë operacionet/zërat e mirëmbajtjes dhe riparimeve të kryera prej tij dhe të informojë periodikisht Autoritetin Kontraktor me anë të raporteve të plotesuar posaçërisht.

## 3.5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË MIRËMBAJTJES

### 3.5.1 Të Përgjithshme

Në përmbushjen e detyrimeve të tij Operatori Mirëmbajtës, do të kryejë të gjitha shërbimet e lidhura për Mirëmbajtjen dhe Riparimin e aseteve, përfshirë instalimet e tyre, me qëllim mbajtjen e tyre gjatë gjithë kohës në gjëndje shumë të mirë funksionimi.

### 3.5.2 Veprimtaritë për Mirëmbajtjen

Operatori i mirëmbajtjes do të kryejë të gjitha shërbimet e lidhura me punët për Mirëmbajtjen dhe Riparimin, duke pasur parasysh se :

- Mirëmbajtja e programuar për pajisjen, do të kryhet nga operatori kurdoherë në vendin ku është e vendosur Aseti, pajisja dhe/ose instalimi.

Në këto raste, operatori është i detyruar të garantojë se kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes prej tij, nuk do të përbënte ndonjë rrezik për personelin që ndodhet në godinë, gjatë kësaj kohe.

- Operatori ka për detyrë që në të gjitha rastet e ndërhyrjeve të tij të mirëmbajtjes, të krijojë,

organizojë dhe të përshtasë zgjidhje të përkohshme alternative, kur kjo është e mundur, për të siguruar vazhdimësinë e kryerjes së detyrave nga ana e personelit që ndodhet në godinë.

## 3.6 PJESËT E KËMBIMIT

### 3.6.1 Sigurimi i Pjesëve të Këmbimit

Për realizimin e veprimtarisë së Mirëmbajtjes, Operatori do të sigurojë dhe mbajë rezervë në magazinën e tij, të gjithë pjesët e këmbimit dhe materialet e tjera të nevojshme për kryerjen e detyrave në mënyrë normale dhe pa mungesa.

### 3.6.2 Evidentimi i Nevojave

Menjëherë me fillimin e zbatimit të kontratës së mirëmbajtjes,Operatori Mirëmbajtjes do të kryejë një analizë/studim, me qëllim evidentimin e nevojave për pjesë këmbimi e materiale, i cili do të bazohet në gjendjen teknike aktuale të aseteve, pajisjeve të caktuara për t'u mirëmbajtur.

### 3.6.3 Rezerva fillestare e pjesëve të këmbimit

Me qëllim që ndërhyrjet mirëmbajtëse të jenë fleksibël dhe pa vonesa, që në fillim të zbatimit të kontratës, operatori duhet të sigurojë një rezervë fillestare të domosdoshme të pjesëve të këmbimit dhe materialeve.

Rezerva fillestare e pjesëve të këmbimit, përfaqëson atë llojshmëri dhe sasi të tyre, të klasifikuara të domosdoshme për të garantuar funksionimin e Aseteve, pajisjeve në kushte emergjente ose të ndërhyrjeve mirëmbajtëse gjatë turneve.

Sasitë, caktohen në varësi të nevojës që ka Autoriteti Kontraktor, mbështetur në rekomandimet, normat e praktikat më të mira të zbatuara dhe janë në ngarkim të operatorit dhe të përfshira në Çmimin e Kontratës.

**3.6.4** Origjinaliteti i Pjesëve të Këmbimit

Gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, operator i Mirëmbajtjes, duhet të sigurojë se të gjithë pjesët e këmbimit apo komponentët e ndërruar të Asetit, pajisjeve duhet të jenë të reja dhe sipas parametrave teknikë të kërkuar.

3.6.5 Materialet e Konsumit, pajisjet dhe Veglat e punës.

Është përgjegjësi e Operatorit të Mirëmbajtjes, të sigurojë dhe mbajë rezervë në magazinë, materialet e konsumit, të mjaftueshme për të garantuar në çdo rast kryerjen e operacioneve të mirëmbajtjes dhe riparimit nga ana e tij në mënyrë normale dhe pa mungesa.
Operatori do të jetë përgjegjës për blerjen dhe disponueshmërinë në ambientet e tij, të gjithë furnizimet e nevojshme për këtë qellim.

Operatori do të jetë përgjegjës gjithashtu për blerjen dhe disponueshmërinë e të gjithë instrumentave e veglave që i nevojiten për kryerjen e detyrave të tij.

Çdo shpenzim për blerjen e materialeve të konsumit dhe të instrumentave, pajisjeve e veglave të punës, do të jenë në ngarkim të operatorit dhe të përfshira në Çmimin e Kontratës, ai nuk do t'i adresohet A.K ose ndonjë pale të tretë për ndonjë pretendim.

## 3.7 CILËSIA E KRYERJES SË SHËRBIMEVE, TREGUESIT E PERFORMANCËS SË KËRKUAR

Operatori mirëmbajtës do të programojë, planifikojë, menaxhojë dhe realizojë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për të mbajtur në gjendje funksionimi sa më të mirë, Asetin dhe pajisjet te specifikuara në dokumentet e tenderit, me synim për të realizuar një performancë funksionimi të kënaqëshme.

## 3.8 DETYRIMET E OPERATORIT TË MIRËMBAJTJES

Operatori Mirëmbajtës, do të mbulojë të gjithë kostot e lidhura me ushtrimin e veprimtarisë së tij të mirëmbajtjes, të lidhura me:

- Kostot e Personelit, për pagat ndaj personelit të tij për kryerjen e shërbimeve mirëmbajtëse;
- Kostot e kryerjes së shërbimeve, të operacioneve të mirëmbajtjes dhe riparimit (taksa dhe tatime që burojnë nga aktiviteti apo shërbimi i ofruar;
- Kostot e materialeve të konsumit dhe transporti i tyre, të caktuara në detyrimin e tij sipas TER dhe specifkimeve teknike.

Detyrime të Tjera

Operatori merr përsipër të mirëmbajë të gjitha ambientet e punës dorëzuar atij dhe t'i mbajë ato në gjendje të mirë gjatë gjithë periudhës së zbatimit te kontratës.

Ai nuk duhet të ndërhyjë, të heqë, të prishë apo të modifikojë me qëllim përshtatje apo përmirësimi ambientet e punës, pa siguruar më parë miratimin me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori duhet të kthejë përsëri ambientet e punës, në fund të kontratës, në gjendje të mirë pa dëmtime dhe të mirëmbajtura.

Detyrimet për Sigurimin teknik, Higjena dhe Siguria në punë.

Operatori do të zhvillojë dhe zbatojë një kod të sigurisë dhe rregullave të higjienës në punë.

Operatori Mirëmbajtës duhet të furnizojë personelin e tij me veshje/uniforma pune dhe mjete mbrojtëse të sigurisë që lidhen me rrezikun ne punë, të cilat do të jenë të identifikuara me logon e tij të kompanisë.

Operatori duhet të informojë dhe instruktojë personelin e tij për respektimin e ssigurimit teknik dhe higjienës në punë.

Operatori, do të kryejë shërbimet në atë mënyrë, që të mos paraqesë ndonjë rrezik për dëmtime të personave apo të pasurisë.

Operatori, do të largojë të gjitha mbetjet e prodhuara si shkak i ushtrimit të veprimtarisë së tij të mirëmbajtjes, jashtë kufijve të portit Durrës, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullat për këtë qëllim.

Operatori do të jetë i vetmi përgjegjës për identifikimin në vijim të çdo rrethane të pasigurtë në punë që ka nisur gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes nga ana e tij.

per personelin e tij. Veshjet dhe mjetet mbrojtëse do të mbajnë shenjat dalluese të operatorit.

**3.9 <u>PERIUDHA ZBATIMIT TË KONTRATËS, FILLIMI DHE DORËZIMI</u>**

Kjo kontratë shërbimi do të jetë me afat ekzekutimi 12 muaj, nga data e lidhjes së saj.

**3.9.1** <u>Dorëzimi</u>

Dy muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmerisë së kësaj kontrate, Operatori Mirëmbajtës, duhet të marë të gjitha masat dhe të bashkëpunojë plotësisht për t'i transferuar pasardhësit shërbimin, në një mënyrë të vijueshme dhe pa probleme, e kryer kjo sipas <u>një Programi Trasferimi që do të hartohet për këtë qëllim.</u>

Program- Trasferimi do të pregatitet nga Operatori në bashkëpunim me pasardhësin e tij, i mbikëqyrur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Ky program do të zbatohet brënda një periudhe kohore prej 60- ditësh para përfundimit të afatit të kontratës.

Qëllimi i këtij programi është, të garantojë një tranzicion të butë të administrimit të operacioneve të mirëmbajtjes dhe riparimit tek pasuesi i tij, e bërë kjo nën mbikëqyrjen e plotë të Autoritetit Kontraktor.

**3.9.2** <u>Dokumenti Përmbledhes,</u>

Operatori do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një dokument përmbledhës, i cili do të përmbajë sa më poshtë :

- Inventarin e të gjithë Aseteve dhe Pajisjeve të caktuara për mirëmbajtje dhe riparim.

- Një raport në lidhje me njohuritë e vecanta të arritura gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë të gjithë propozimet për përmirësim.

- Një listë të plotë të dokumentave teknike.

- Një raport të pajisjeve nën mirëmbajtje ose riparim.

- Një raport që liston mosfunksionimin ose prishjet e pajisjeve që nga momenti i marrjes së përgjegjësisë për ushtrimin e veprimtarise se mirëmbajtjes. Në funksion të këtij raporti, operatori duhet të administrojë të gjitha pjesët e këmbimit, pajisjet e dëmtuara apo të

nxjerra jashtë funksionit në ambientin e tij të punës (magazinën e tij).

- Operatori Mirëmbajtës, ka si detyrim dorëzimin e këtij informacioni në mënyre elektronike, apo me shkresë zyrtare, në përfundim të zbatimit të kontratës.
-

## 4 PËRGJEGJËSIA

Operatori konsiderohet të jetë përgjegjës për të gjitha gabimet, pakujdesinë në kryerjen e detyrave të ushtruara prej tij ose përfaqësuesve të tij

Kompesimi i kostove për humbje të shkaktuara

Operatori merr përsipër të kompensojë Autoritetin Kontraktor, për të gjitha kostot e humbjeve apo dëmtimeve të shkaktuara këtij të fundit, të cilat kanë ndodhur për shkak të gabimve e pakujdesive gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nga ndonjë palë e tretë e atorizuar nga ai, apo nga kushdo nga punonjësit e tij.

Kompesimi i kostove për rrjedhojë e humbjeve të shkaktuara

Ai gjithashtu, merr përsipër të kompensojë ASDC-në, për çfarëdo ankesë, pretendim, proçedura e detyrime që lindin nga këto humbje, dëmtime etj.

## 5. ZGJIDHJA E KONTRATËS,

Dështimi në vazhdimësi në zbatimin korrekt të detyrave

Nëse operatori Mirëmbajtjes, dështon në vazhdimësi, në zbatimin korrekt të detyrave sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e shërbimit, me theks të veçantë arritjen e detyrimeve të tij të performancës, si dhemegjithë paralajmërimet e A.K deshton gjithashtu në përpjekjet e tij për të korregjuar difektet apo mangësitë e evidentuara brenda një periudhe kohe të specifikuar, A.K është e detyruar t'i nënshtrohet procedurave për zgjidhjen e kontratës

Kushte që justifikojnë prishjen e Kontratës

Konsiderohet serioze shkelja e afateve dhe kushteve që justifikojnë zgjidhjen e kontratës, nëse operatori zvogëlon performancën e tij më shumë se 10 % nën objektivat e vendosura në kontratë për dy muaj në vazhdimësi, pavarësisht paralajmërimeve mujore periodike të përsëritura me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Mirëmbajtja dhe riparimi i dobët,

Evidentimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të dobët të Aseteve të caktuara operatorit për mirëmbajtje do të jetë objekt i vlerësimeve për përcaktimin e dëmit të pësuar, i cili do të jetë i detyrueshem për tu paguar nga Operatori i Mirëmbajtjes.

## 6. ZËRAT E SHËRBIMEVE QË DO TË KRYHEN PËR MIRËMBAJTJEN E OBJEKTIT "ZYRAT MODULARE PËR AGJENCITË DOGANORE" (SIPAS PROGRAMIT TË MIRËMBAJTJES)

## 6.1 SHËRBIMI I PASTRIMIT TË OBJEKTIT "ZYRAT MODULARE PËR AGJENCITË DOGANORE"

Shërbimi i pastrimit do të kryhet 6 ditë në javë nga dita e Hënë në të Shtunë. Pastrimi do të kryhet me mjete të zakonshme pastrimi. A.K ka parashikuar fshirjen me fshesë dore dhe larjen me leckë të të gjithë godinës.

E gjithë godina në tërësi do të fshihet dhe lahet çdo ditë nga ora 07:00 AM-09:00 AM nga 3 punonjës/e sanitar/e, të cilët duhet të pajisen me uniformën përkatëse (përparëse verore/dimërore) e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt dhe doreza pune.

Duke qënë se godina është 3-katëshe, A.K ka parë të arsyeshme të kërkojë 3 (tre) punonjës të shërbimit sanitar, nga një për secilin kat.

**6.1.1** Shërbimi i pastrimit në godinën *"Zyrat modulare për agjencitë doganore"* do të përfshijë si ambientet e jashtme dhe të brendshme të godinës, sipas grafikut/frekuencës të përcaktuar nga A.K.

| Nr. | Objekti | Njësia | Sipërfaqe e brendshme (në m2) | Sipërfaqe e jashtme (në m2) | Numri mesatar i personelit në godinë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | "Zyrat modulare për agjencitë doganore" | $m^2$ | 2654 | 3139 | 240 |

**6.1.2 <u>Shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme që do të pastrohen çdo ditë në godinën "Zyrat modulare për agjencitë doganore" sipas specifikimeve të mëposhtme:</u>**

- **Zyrat** të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë edhe në raste të veçanta sipas nevojës. Me pastrim të zyrave do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe çdo pajisje tjetër që ndodhet brenda sipërfaqes së zyrës. Fshirje dhe larje e dyshemesë me solucionet përkatëse, Qeset e mbeturinave nëpër kosha të zbrazen dhe ndërrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë.
- **"Dhoma teknike"** të pastrohet jo më pak se 1 (një) herë në ditë. Fshirje larje e dyshemesë me solucionet përkatëse dhe marrja e pluhurave e larja me leckë nga jashtë e xhamave tëpanelit ku është instaluar sistemi qëndror i monitorimit me kamera, paneli i kontrollit të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe tymit, sistemi RACK i shpërndarjes së linjave të internetit për secilën zyrë etj.
- **Korridoret, shkallët** të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë dhe në raste të veçanta sipas nevojës. Fshirje dhe larje e shkallëve dhe korridoreve me solucione përkatëse.
- **Pastrimi i tualeteve** do të bëhet jo më pak se 1 (një) herë në ditë dhe në raste të veçanta sipas nevojës duke u bërë kontrolli i vazhdueshëm i pastërtisë së tualeteve.Pastrimi i pajisjeve të tualeteve dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë do të kryhet sipas nevojave ditore. Larja bëhet me solucion dezinfektues. Në ambientet e tualeteve të përdoren solucione aromatike. Qeset e mbeturinave të nëpër kosha të zbrasen dhe

ndërrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë si dhe të dezinfektohen koshat e tualeteve sa herë që ndërrohen qeset.

- **Tarracat/ballkonet e godinës** të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë edhe në raste të veçanta sipas nevojës.Fshirje dhe larje e dyshemesë me solucionet përkatëse.
- **Dyert e brendshme, dyert e emergjencave dhe dyert hyrëse të godinës** të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë edhe në raste të veçanta sipas nevojës. Fshirje dhe larje me solucion larës.
- **Dritaret e tualeteve nga brenda të godinës** të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë edhe në raste të veçanta sipas nevojës. Fshirje dhe larje me solucion përkatës për xhama.

### 6.1.3 Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme të godinës që do të pastrohen çdo ditë

Me sipërfaqe të jashtme do të kuptojmë të gjithë hapësirat, sheshet rreth e përqark godinës që janë në funksion të saj (parkingu). Shërbimi i pastrimit të jashtëm ditor përfshin fshirjen e oborrit dhe larjen e tij çdo ditë në mëngjes.

Mbeturinat që do të pastrohen të futen në qese plastmasi dhe të çohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave të përcaktuara nga Pushteti Vendor. Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen. Duhet të ndërrohen të pakten 1 (një) herë në ditë qeset plastike në koshat e vendosur në ambientet e jashtme.

### 6.1.4 Shërbim pastrimi i ambienteve të godinës që do të pastrohen të paktën çdo muaj

- **Fasada e xhamave të godinës nga brenda dhe jashtë,** të pastrohet të paktën 1 (një) herë në muaj edhe në raste të veçanta sipas nevojës. Fshirje dhe larje me solucion përkatës për xhamat.

Pajisja e nevojshme që do të duhet për fshirjen dhe larjen e xhamave të fasadës së jashtme të godinës është:

**Platformë ngritëse për pastrime në lartësi,** me lartësi jo më pak se 7 metra dhe peshëmbajtje e platformës minimumi 100 kg, e cila vjen në ndihmë për mbajtjen e punëtorëve për kryerjen e shërbimit sikurse është pastrimi i fasadave të jashtme të godinës.

### 6.1.5 Shërbimi i evadimit të mbetjve urbane

Operatori i mirëmbajtjes do të kujdeset çdo ditë për grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara nga Pushteti Vendor.

A.K që të sigurohet se Operatori i mirëmbajtjes do të jetë i specializuar për kryerjen e operacioneve të sigurta të pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane dhe ujrave të zeza (pastrimi i gropës septike) deri në destinacionin përfundimtar të tyre, kërkon që ky operator të jetë i licesnuar nga QKL për kryerjen e këtij aktiviteti/shërbimi.

Operatori i mirëmbajtjes shërbimin e evadimit/transportimit të mbetjeve urbane do ta kryejë nëpërmjet **mjetit teknologjik me këto specifikime teknike:**

- të ketë aftësi ngjeshëse;
- të jetë me ngarkim fundor ose anësor;

- të ketë kapacitet mbajtës jo më të vogël se 1 ton;

**6.1.6 Shërbimi i Dezinfektimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës** të kryhet të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj, me pajisje dhe solucione përkatëse dhe për çdo event të lajmëruar paraprakisht nga Operatori i shërbimit.

Për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit, nga Operatori i mirëmbajtjes të kihet parasysh që ky shërbim të kryhet në ditë pushimi sikurse është dita e dielë, në mënyrë që godina të mos jetë me personel.

Shërbimi i dezinfektimit duhet të ofrohet sipas përcaktimeve të Udhëzimit të përbashkët të APP dhe MSHMS nr. 294 date 06.05.2020 (ose në përputhje me çdo ndryshim që mund të pësojë ky udhëzim përgjatë zbatimit të kontratës).

Dezinfektimi i ambienteve duhet të kryhet me dezinfektant. Produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, duhet të jenë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë vetëm "për përdorim profesional".

Produktet Biocide duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur në kohën e përcaktuar.

Produketet Biocide nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën, shëndetin e njerëzve, bimëve si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

Nuk duhet të përdoret asnjë produkt apo preparat që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem.

**Preparat për dezinfektim:** Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë komponime të amonit kuaternar: (Benzyl-C12-16-alkyldimethylchlorides (CAS no.68424-85-1) 15% -30% , Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS no.7173-51-5) 5%-15%, Glutaradehyde (CAS no.111-30-8) 5%-15% dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit).

**Paketimi:** Në konfeksion plastik nga 1 deri në 5 litra dhe sipas kërkesave të AK. Paketimi duhet të jetë i etiketuar në gjuhën shqipe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin, dhe ambalazhimin e kimikateve" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 487, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide"; Ligjit Nr. 9902, datëb 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" i ndryshuar dhe Ligjit nr.95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik"

Dezinfektimi do të kryhet nëpërmjet pajisjes së mëposhtme:

**Pompë profesionale dezinfektimi të thjeshtë krahu**, sipas nevojave specifike të ambienteve, nëpërmjet mënyrave si psh:

- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, që garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulim 100% të ambientit (kryesisht ambiente të vogla zyrash, tualetesh etj ), me pajisjet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj).

- me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave tëvogla të preparatit dhe mbulim 100% të ambientit (kryesisht për spërkatje sipërfaqesh dyshemeje, korridore muresh të jashtme etj) me mjetet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj).
- me spërkatje mjegulluese në të nxehtë, minimumi 10 metra largësi (kryesisht për sipërfaqe të jashtme, ballkone, sheshe pushimi, holle të hapura etj) me pajisjet përkatëse (pompë/çantë shpine me presion etj).

Në kushtet kur, shërbimi i dezinfektimit është i rëndësishëm për sigurinë dhe shëndetin publik, A.K që të sigurohet së operatori i mirëmbajtjes është i kualifikuar për të kryer këtë detyrë me kujdes dhe profesionalizëm dhe se ka njohuri të mjaftueshme në lidhje me metodat dhe substancat e përdorura për dezinfektimin, kërkon licensimin e këtij subjekti nga QKL për kryerjen e këtij shërbimi.

**Detyrat:**

Përpara kryerjes së këtij shërbimi, Përgjegjësi i mirëmbajtjes së OE duhet të bëjë fillimisht inspektimin e situatës dhe terrenit të jashtëm e të brendshëm, për të përcaktuar në mënyrë sa më të saktë të jetë e mundur, vendet e nevojshme dhe me të përshtatshme, në të cilat duhet të kryhet dezinfektimi. Sipas frekuencës së kërkuar të shërbimit, Përgjegjësi i mirëmbajtjes së OE duhet të bëjë monitorimin e situatës dhe verifikimin e rezultatit të shërbimit. Nëse shërbimi nuk ka dhënë rezultat ai duhet të përsëritet sërish.

Shërbimi duhet të kryhet nga një punonjës - specialist i fushës, me eksperincë për përdorimin e produkteve me rrezikshmëri të lartë, në një kohë sa më të përshtatshme, pa cënuar mbarëvajtjen e punës së punonjësve që ushtrojnë aktivitetin privat të tyre në godinën "Zyrat modulare për agjencitë doganore" dhe pa rrezikuar jetën e tyre.

Punonjësi i caktuar nga OE për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit duhet të jetë i pajisur me veshjen e përshtatshme mbrojtëse (maskë, syze, cizme, doreza, kapuc, veshje mbrojtëse specifike që mbulon të gjitha pjesët e trupit etj).

**Detyrat e Kontraktuesit lidhur me shërbimin e pastrimit:**

- Të marrë përsipër të sigurojë me shpenzimet e veta materialet e pastrimit, pajisjet, veglat e punës dhe makineritë e nevojshme, që nevojiten për përmbushjen e kontratës.
- Operatori i shërbimit do të bëjë kontrollin ditor dhe sigurojë brenda këtij shërbimi të gjitha materialet e konsumit të përdorimit të përditshëm në tualete (letër higjenike, letër duarsh, sapun i lëngshëm duarsh, të gjithë detergjentët e nevojshëm etj) si dhe aksesorë për vendosje letër higjenike, aksesorë për vendosje letër duarsh, kosha mbeturinash për zyra, korridore e tualete, deri në përfundimin e kontratës.
- Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas nevojave dhe konsumimit, nën kujdesin e Përgjegjësit të mirëmbajtjes të Kontraktuesit i cili duhet të bëjë shpërndarjen e tyre dhe të sigurojë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.
- Transporti i materialeve të pastrimit do të kryhet me mjetet e Operatorit.

**Materialet e nevojshme të pastrimit që do të nevojiten për kryerjen e këtij shërbimi, janë të listuara në tabelën e mëposhtme:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1. | Letër higjenike | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 2. | Letër për fshirje duarsh | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 3. | Shtupë/leckë për pastrimin e dyshemesë | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 4. | Pecetë/leckë për pastrim universal (për xhama, pluhura, mobilje, dyer etj). | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 5. | Kovë plastike për larje dyshemeje | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 6. | Lopatë plastike për mbledhje mbeturinash me bisht të gjatë | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 7. | Fshesë pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 8. | Bishta për fshesa dhe shtupa | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 9. | Solucion larës pllakash, dyshemeje, parketi etj. | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 10. | Sapun i lëngshëm/likuid për larje duarsh | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 11. | Qese mbeturinash 70x85 cm, 70 litra | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 12. | Qese mbeturinash 100x75 cm, 100 litra | Pako | Sipas nevojës të A.K |
| 13. | Solucion dezifektues/higjenizues/zbardhues banjosh | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 14. | Furçë për pastrimin e WC-ve | Copë | 30 |
| 15. | Doreza pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 16. | Sfungjer pastrimi | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 17. | Solucion për pastrimin e mobiljeve, dyerve etj. | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 18. | Solucion për larjen e xhamave | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 19. | Kosh për mbeturina letre, me pedale, për tualetet brenda | Copë | 30 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 20. | Kosh mbeturinash për WC, pranë zonës së lavamanëve | Copë | 10 |
| 21. | Kosh mbeturinash për zyra | Copë | 80 |
| 22. | Mbajtëse letre higjenike | Copë | 30 |
| 23. | Mbajtëse letre për duart | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 24. | Mbajtëse për sapun të lëngshëm | Copë | Sipas nevojës të A.K |
| 25. | Uniforma për personelin e pastrimit | Copë | Sipas nevojës të A.K |

*Shënim: Materialet e pastrimit duhet të jenë shumë cilësore, të cilat nuk duhet të jenë gërryes por pastrues dhe higjenizues.*

**<u>Specifikimet teknike të materialeve të pastrimit :</u>**

1. **Letër higjenike** në pako, jo më pak se 10 rula (me 2 shtresa, e butë, me aromë, me këputje, 100% celulozë). Letra të ketë ngjyrë të bardhë. Duhet që produktet e brendit të kenë certifikatë kualiteti ku të përshkruhet që materiali është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

2. **Letër për fshirje duarsh** në pako me paketim jo më pak se 270 fije, me dy shtresa, ngjyrë e bardhë, që vendosen në aparatet e tyre, të jetë cilësore. Produkti duhet të jetë i certifikuar me certifikatë kualiteti ku të përshkruhet që është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

3. **Shtupë/leckëpër pastrimin e dyshemesë** me material mikrofibër , të jetë e plotë 100% ekologjike. Fijet të jenë në shirita me përmasa 25x4 cm+/- 2 cm.

4. **Pecetë/leckë për pastrim universal** (xhama, pluhura, mobilje, dyer etj) me material mikrofibër (tip peshqiri) e butë dhe e aftë të fshijë njollat me lehtësi, me kualitet cilësor.

5. **Kovë plastike për larje dyshemeje**, me pajisje të montuar në kovë që bën shtrydhje të shtupës. Material rezistent dhe praktik, me kapacitet 15-17 litra.

6. **Lopatë plastike për mbledhje mbeturinash** me bisht të gjatë, material plastik, i lehtë dhe praktik për të pastruar.

7. **Fshesë pastrimi,** e pajisur me bisht të gjatë, me fije të holla e të gjata që nuk këputen plastikë e fortë.

8. **Bishta për fshesa dhe shtupa**, material cilësor dhe rezistent të përshtatet lehtë në fshesë dhe shtupë.

9. **Solucion larës pllakash, dyshemeje**, të jetë sa më i koncentruar (1-200 me ujë), të lërë aromë të lehtë pas larjes, e të mos lërë njolla në pllaka e parkete. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë prodhim me standarte të EU dhe i certifikuar sipas standarteve EU. Përmasat nga 1 -10 litra. Të jenë linja profesionale . Niveli i PH- (8+/- 5%).

10. **Sapun i lëngshëm për larje duarsh,** ambalazhimi të jetë në bidona plastike nga 3-5 litra. Të jetë i certifikuar, të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë antibakterial,

me aftësi shkumuese të lartë, të ketë aromë të lehtë, i butë për lëkurën dhe i testuar dermatologjikisht. Niveli i PH (6+/-5%).

11. **Qese mbeturinash** me përmasa 70x85 cm, me kapacitet 70 litra, qeset të jenë plastike, rezistente dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje/copë.

12. **Qese mbeturinash** me përmasa 100x75 cm, me kapacitet 100 litra, qeset të jenë plastike, rezistente dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje/copë.

13. **Solucion dezifektues/higjenizues/zbardhues banjosh**, për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve, veshjeve porcelani, hidrosanitareve. Të heqë pikat e bardha të ujit. Të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim minimum nga 1-150 në 1-200 me ujë. Masat nga 1-10 litra. Të jenë linja profesionale. Niveli i PH – (1-2).

14. **Furçë për pastrimin e WC-ve**, e përbërë nga material rezistent plastik, me kokë me fije plastike të forta dhe mbajtëse plastike, lehtësisht e përdorshme dhe e pastrueshme.

15. **Doreza pastrimi**, material latex, të trasha, të gjata, me përmasë Medium, që përdoren gjatë larjes së tualeteve apo ambienteve të tjera të godinës.

16. **Sfungjer pastrimi,** e përbërë nga 2 anë, njëra anë e butë për të larë dhe ana tjetër me rrjetë për të fërkuar dhe zhdukur të gjitha sipërfaqet e papastra duke përfshirë ato më delikate. Nuk lë njollë.

17. **Solucion për pastrimin e mobiljeve, dyerveetj**, në formë spray, me përmasa 500 ml, të jetë prodhim me standartet të EU dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë.Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8-9).

18. **Solucion për larjen e xhamave,** në formë spray, me përmasa 500-750 ml, të jetë prodhim me standartet të EU dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8.5-9).

19. **Kosh për mbeturina letre, pranë zonës së lavamanëve** me pedale, të cilët do të vendosen në zonën para tualete, ku ndodhen lavamanët me qëllim për të hedhur letrat që do të përdoren për fshirjen e duarve. Material plastik rezistent, me kapak, me kapacitet mbi 50 litra.

20. **Kosh mbeturinash për WC**, **në zonën e tualeteve brenda,** me ose pa kapak, material plastik rezistent, me kapacitet 6-10 litra.

21. **Kosh mbeturinash për zyra**, me rrjetë metalike, rezistente, rrethor, ngjyrë e zezë, me kapacitet 16-20 litra.

22. **Mbajtëse letre higjenike**, që montohet në mur, material inoksi, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. E përshtatshme për të gjitha madhësitë standarte të letrës higjenike.

23. **Mbajtëse letre për duart**, që montohet në mur, material inoksi ose plastik, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. E përshtatshme për të gjitha madhësitë standarte të letrës së duarve. Me kapacitet jo më pak se 500 letra.

24. **Mbajtëse për sapun të lëngshëm**, që montohet në mur, material plastik ose inoksi, rezistent ndaj ndryshkut dhe kimikateve të ndryshme. Me kapacitet 1000 ml.

25. **Uniforma për personelin e pastrimit**, të jenë material pambuku, me kopsa, të përshtatshme për dimër dhe verë, me përmasa standarte.

**Rregulla për tu zbatuar:**

- Operatori i shërbimit duhet të mbajë pastër çdo sipërfaqe ambienti brenda dhe përreth godinës.
- Për asnjë rast nuk do të lejohen dysheme të papastruara apo mbeturina të palarguara në to.
- Pajisjet dhe mjetet e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- Të bëhet kujdes që gjatë pastrimit me fshesë të parandalohet përhapja e pluhurit që mund të përmbajë mikroorganizma.
- Të ndërrohen shpesh leckat e pastrimit në mënyrë që të parandalohet aroma e keqe.
- Në rastet kur për arsye objektive në godinë rrjeti nuk ka ujë të pijshëm, nga ana e operatorit të shërbimit duhet të merren masa për furnizimin e depozitave me ujë nëpërmjet Autobotit me kapacitet të nxënies së rezervuarit jo më pak se 1000 litra ujë.

## 7.1 SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË RRJETIT HIDRIK TË GODINËS

Operatori, npërmjet Përgjegjësit të tij të mirëmbajtjes dhe punonjësit të kualifikuar, specialist i fushës-hidraulik do t'i përgjigjet të gjitha nevojave të A.K për mirëmbajtjen e rrjetit hidrik në gjendje sa më të mirë shfrytëzimi.

Operatori për riparime, rregullime të defekteve të rastit, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, duhet të sigurojë me shpenzimet e tij mjetet, pajisjet, veglat e punës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Operatori i mirëmbajtjes gjatë procesit të rregullimit të defekteve në rrjet apo, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, duhet të ketë ne vëmendje që të garantojë një funksionim normal dhe pa ndërprerje të furnizimit me ujë të godinës.

Operatori i mirëmbajtjes ka detyrimin që çdo ndërrim, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, apo prishje, thyerje të pajisjeve hidrosanitare ta vendosë të re, në mënyrë që të garantojë mirëfunksionimin në vijueshmëri të tyre.

Zëvendësimi i pjesëve të rrjetit hidrik apo i pajisjeve hidrosanitare do të kryhet me material të të njëjtave parametrave teknike me ato ekzistues.

Operatori, me qëllim mirëmbajtjen e tubacioneve të tualeteve dhe kanalizimeve të kullimit larjen periodike të tyre si dhe hapjen e tubacioneve në rast bllokimi duhet të përdorë pajisjen e quajtur **Sondë teknologjike e cila duhet të jetë me pompë vakumi dhe presioni.**

Operatori i mirëmbajtjes është i detyruar që të bëjë me shpenzimet e tij furnizimin e materialeve hidraulike sa here të jetë e nevojshme për nevoja të A.K dhe mban përgjegjësi për kualitetin e tyre në bazë të parametrave, specifikimeve teknike të artikujve. Nëse do të konstatohen se artikujt nuk plotësojnë karakteristikat dhe parametrat teknike të përcaktuara me poshtë, ai detyrohet të zëvendësoje sasinë e furnizuar të artikujve.

Transporti i materialeve hidraulike do të kryhet me mjetet e Operatorit.

**Listë e materialeve hidraulike të nevojshme që do të përdoren sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas tabelës më poshtë:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Set grup lavamani | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 2 | Tuba fleksibël | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 3 | Mishelatorë | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 4 | Saraçineskë | Cope | Sipas nevojës së A.K |
| 5 | Piletë + Shkarkues | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 6 | Galixhantë | Cope | Sipas nevojës së A.K |
| 7 | Gomina për grupe WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 8 | Kasetë shkarkimi WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 9 | Nenjëse plastike WC | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 10 | Bolierë të ujit të ngrohtë sanitary | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 11 | WC porcelani | Copë | Sipas nevojës së A.K |
| 12. | Lavamanë porcelani | Copë | Sipas nevojës së A.K |

**<u>Specifikimet teknike të materialeve hidraulike:</u>**

9. **Set Grup lavamani, të jetë i montueshëm në lavaman,** në formë cilindrike ose katrore prej inoksi.
10. **Tuba fleksibël** M Ø 3/8, të jenë material PVC i cilësisë së lartë, që të përdoren për furnizim me ujë. Lavamanët lidhen me sistemin e furnizimit me ujë me anë të dy tubave fleksibel me gjatësi 30 - 50 cm dhe diameter ½, të cilët bëjnë lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me ujë të ngrohtë dhe ujit të zakonshëm. Në vendin e lidhjes së rubinetit me lavamanin duhet të vendosen gominat e përshtatshme, për të mos bërë lejimin e rrjedhjes së ujit.

11. **Mishelator lavamani** për instalim në lavaman, Prurja 3 l/min. Buton me shtypje dhe pulsant në bronx të kromuar. Kokë ndërrimi të valvulës së brendshme. Pjeset e brendshme dhe pjesët e tjeta të ndryeshme të jenë rezistente ndaj ndryshkjes dhe antikalcium. Sistem kundër bllokimit.

12. **Saraçineska**t janë pajisje të veçanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Me anë të saraçineskave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që i jepet pjesës tjetër të tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saraçineskat mund të jenë me material bronxi, gize. Ato janë të tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim

ose me fllanxha. Saraçineskat sipas mënyrës së bashkimit me tubat i ndajmë në lloje: a) me fllanxhë dhe b) me fileto. Saraçineskat përbëhen prej pjesëve të mëposhtme: Trupi cilindrik prej gize ose bronxi. Në këtë trup duhet të fiksohen fllanxhat përkatëse, të cilat shërbejnë për lidhjen e saraçineskës me tubacionin e rrjetit. Disku ose sfera i cili duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e saraçineskës. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj. Volanti apo leva, e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut nëpërmjet lëvizjes vertikale rrotulluese. Kapaku i saraçineskës, i cili lidhet me anë të bullonave dhe dadove me trupin cilindrik të saraçineskës ose me filetim.

13. **Piletë + shkarkues** fleksibël është elementi kryesor i cili realizon shkarkimin e ujërave Materiali përbërës është PP(polipropilen) i cili ofron rezistencë të lartë ndaj kimikateve dhe veti të shkëlqyera izoluese. Përmasa e lidhjes me piletën është 1x1/2 me një diameter shkarkimi 32 mm.

14. **Galixhant i kasetës,** realizon sistemin e plotë të qarkullimit të ujit në kasetë. Kur arrihet niveli i ujit ky mekanizëm mbyll valvulën që furnizon kasetën. Furnizimi me ujë realizohet vertikalisht me diametër 3/8 dhe adaptor 1/2.

15. **Gomina për grupe WC**, është një aksesor hidraulik i cili shërben për të lidhur kasetën plastike me WC-në. Materiali i gomës i jep fleksibilitet, një izolim perfekt dhe rezistencë të lartë.Ngjyra e bardhë, materiali gomë.

8. **Kasetë WC**, materiali porcelan, të jetë me mekanizëm. Lartësia 80 cm.

9. **Ndenjëse plastike e WC-së,** material plastikë cilësore dhe rezistente ndaj thyerjeve, ngjyra e bardhë.

10. **Bolierë të ujit të ngrohtë sanitar.** Uji i ngrohtë sanitar është i kompozuar të realizohet prej prodhuesit të energjisë termike që në rastin tonë do të jenë bolirët elektrik si dhe tubacionet e pajisjes për furnizimin dhe rregullimin e ujit. Madhësia e tij është kalkuluar në fuksion të nevojave për ujë sanitar dhe karakteristikat e tij duhet të jenë përcaktuar qartë në çertifikatën e kualitetit të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Karakteristikat teknike kryesore janë praqitur më poshtë:

*Tipi:* Boiler horizontal i termoizoluar me shkëmbyes inoksi të ç’montueshem;

*Izolimi:* Shtresë fleksibile shkumë polyuretan 50 mm trashesi;

*Veshja e jashtme:* Çeliku me karbon, i mbrojtur me një shtresë epoxidi në ngjyrë të bardhë e polimerizuar;

*Mbrojtja:* Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magneze e thjeshte;

*Kapaciteti :* 20 lit – 60 lit, Pmax 8 bar, Tmax 95 0C;

*Kondita e punës :* Pmax 8 bar, Tmax 95 0C.

11. **WC për tualet**, me montim në tokë ose në mur, me përmasa të ëc-ve aktuale, materiali porcelan cilësor dhe rezistent ndaj thyerjeve, ngjyra e bardhë.

12. **Lavamanë me kolonë për tualet,** materiali porcelan, i cili ofron qëndrueshmëri dhe lehtësi pastrami, ngjyra e bardhë. Përmasat e lavamanit do të jenë sipas përmasave të lavamanëve aktualë që gjenden në tualete.

## 8.1 SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË GROPËS SEPTIKE, PËR NEVOJAT E ZYRAVE TË REJA MODULARE

Gropa septike është e përbërë nga 3 dhoma me dimensione 655 mm x 2425 mm x 2800 mm me peshë 1100 kg.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i mbetjeve të ujërave të zeza do të bëhet në mënyrë periodike, me frekuencë (njëherë në muaj) me qëllimin për moskalicifikimin e mbetjeve. Ngurtësimi i tyre krijon pamundësi të heqjes dhe për një periudhë kohe mund të ngrihet edhe niveli i gropes septike.

Për pastrimin e mbetjeve të ujërave të zeza Operatorit i nevojitet një **Automjet teknologjik për thithje dhe largim të ujërave të ndotura, me këto parametra teknike:**

Autoboti të jetë I përbërë nga një depo e ujërave të zeza dhe një pompë vakumi, e cila përdoret për të pompuar, transferuar ose asgjësuar ujërat e zeza nga gropa septike.

Autoboti të ketë këto veçori:

- të ketë Vetë-mbushëse, vetë-shkarkuese;

- të ketë kapacitet mbajtës jo mëpak se 1000 litra.

Pastrimi i gropes septike do të përfshijë:

- Hapjen e kapakut;
- Thithjen me autobot të ujrave të zeza;
- Zhbllokimin e kanalizimit në rastet e nevojshme;
- Dezinfektimin me klor;
- Mbylljen e kapakut;
- Transportin e ujërave të zeza për në pikën e riciklimit.

Ky automjet është parë i nevojshëm të kërkohet nga A.K bazuar edhe në Relacionin Teknik "Për blerje dhe vendosje grope septike përnevojat e zyrave të reja modulare" *(të cilin do ta gjeni bashkëlidhur dokumenteve të tenderit).*

## 9.1 SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË RRJETIT ELEKTRIK TË GODINËS

Operatori, npërmjet Përgjegjësit të tij të mirëmbajtjes dhe punonjësit të kualifikuar, specialist i fushës- elektricist do t'i përgjigjet të gjitha nevojave të A.K për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik në gjendje sa më të mirë shfrytëzimi.

Operatori për riparime, rregullime të defekteve të rastit, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, duhet të sigurojë me shpenzimet e tij mjetet, pajisjet, veglat e punës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Operatori i mirëmbajtjes gjatë procesit të rregullimit të defekteve në rrjet apo, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, duhet të ketë ne vëmendje që të garantojë një funksionim normal dhe pa ndërprerje të furnizimit me energji të godinës.

Operatori i mirëmbajtjes ka detyrimin që çdo ndërrim, zëvendësim të pjesëve të rrjetit, apo prishje, thyerje të pajisjeve elektrike (çelësa, priza, ndriçues led etj) ta vendosë të re, në mënyrë që të garantojë mirëfunksionimin në vijueshmëri të tyre.

Zëvendësimi i automateve, çelësave, prizave, kutive, kabllove, përcjellsave, llampave e ndriçuesve etj të dëmtuara do të kryhet me material të të njëjtave parametrave teknike me ato ekzistues.

Zëvendësimi i llampave të djegura duhet të bëhet sipas zërit të preventivit. Materialet dhe aparatet që duhet të përdoren duhet të kenë të gjitha cilësitë e fortësisë, kohëzgjatjes, izolimit dhe të funksionimit të mirë, dhe duhet gjithashtu të jenë të tilla që t'i reziztojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lagështirës.

Të gjitha kutitë e prizave ose çelësave etj duhet të vendosen në object nëpërmjet kutive të instaluara me llaç çimentoje, duke u kujdesur veçanërisht që instalimi i kutive të mësipërme të bëhet rrafsh me murin në lidhje me sipërfaqet e suvatuara dhe të veshura, në mënyrë që të mos verifikohen dalje apo futje të tepërta të këtyre kutive.

Tubi fleksibël duhet të jetë i ndërfutur në kutitë që përmbajnë çelësat apo prizat, që në asnjë mënyrë të mosdëmtojnë përcjellësit që hyjnë në kuti.

Ndriçuesit duhen fiksuar me siguri në sipërfaqen e tavanit e ambienteve sipas rekomandimit të dhënë nga prodhuesi/distributori i autorizuar.

Operatori i mirëmbajtjes është i detyruar që të bëjë me shpenzimet e tij furnizimin e materialeve elektrike sa here të jetë e nevojshme për nevoja të A.K dhe mban përgjegjësi për kualitetin e tyre në bazë të parametrave, specifikimeve teknike të artikujve. Nëse do të konstatohen se artikujt nuk plotësojnë karakteristikat dhe parametrat teknike të përcaktuara me poshtë, ai detyrohet të zëvendësoje sasinë e furnizuar të artikujve.

Transporti i materialeve elektrike do të kryhet me mjetet e Operatorit.

Për çdo shërbim elektrik që do të kryhet do të vihet në dijeni parapakisht personeli përkatës që ndodhet në godinë duke mos shkaktuar dëme në pajisjet kompjuterike dhe dëme njerëzore.

**Listë e materialeve elektrike të nevojshme që do të përdoren sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas tabelës më poshtë:**

| Nr.rendor | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1. | Çelësa elektrik | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 2. | Suport prizash | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 3. | Kuti shpërndarje elektrike | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 4. | Priza standarte | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 5. | Panele TU | copë | Sipas nevojës së A.K |
| 6. | Nriçues Led | copë | Sipas nevojës së A.K |

**Specifikimet teknike të materialeve elektrike:**

7. **Çelësat elektrikë,** përdoren për të komanduar energjinë elektrike duke fikur ose ndezur një pajisje ose ndriçues të montuar në seri me çelësin, në tension deri në 250 V. Çelësi elektrik të jetë pulsant i thjeshtë, material plastik, 10 A, 1 M, i bardhë. Lartësia e çelësave elektrikë është 110 cm nga dyshemeja. Numri i moduleve sipas atyre që janë ekzsistues në godinë.
8. **Suport prizash,** material plastik, i qëndrueshëm, i cili përdoret për të fiksuar celësat, prizat dhe tapat falso. Në këtë support mund të vendosen 3 Module. Suporti ka të përfshirë vidat. Numri i moduleve sipas atyre që janë ekzsistues në godinë.
9. **Kuti shpërndarje elektrike,** tipi: kuti automati, material plastik, cilësor, të ketë 3 apo 4 module jashtë murit, ngjyra e bardhë.
10. **Priza standarte,** tip shuko, e përbërë nga 2 module, 2P+T, 16A, 250 V, ngjyrë e bardhë. Thellësia 4cm; Materiali: Plastik/bakër; Gjerësia 4.3cm; Gjatësia 4.3 cm.
11. **Panelet e Tensionit të Ulët**, shërbejnë për të garantuar nivelin maksimal të kualitetit dhe performancës dhe të përmbushin kërkesat e standartit IEC Standard: 60439. Standarti IEC 60439-1 aplikohet në ndarësit dhe në montimin e paisjeve të kontrollit për tension jo më të madh se 1000 V, në rrymë alternative dhe frekuencë jo më të madhe se 1000 Hz, ose 1500 V në DC. Ky standart është gjithashtu i aplikueshëm për të gjitha montimet që përdoren për lidhjet me gjenerator, transmetim, shpërndarje dhe shndërrim të energjisë elektrike dhe për kontroll të paisjeve të konsumit të energjisë elektrike. Për të garantuar instalimin gjatë ciklit të jetëgjatësisë së panelit, sistemi i instalimit dhe paisjet duhet të ushqehen nga i njëjti furnizues.

    Specifikimet tekniko-fizike të panelit:

    Lartesia: ≤ 2000m

    Temperatura e ambjentit: standarte

    Temperatura mesatare e ambjentit 35°C

    Lageshtia relative: standate (80% - 35°C)

    Ambjenti klimatik: standard

    Specifikimet Elektrike

    Tensioni Nominal: deri ne 1000 V

    Frekuenca: 50 Hz

    Rryma Nominale: [400] A

    Rrymat e Lidhjes së Shkurter: 85 kA

    Sistemi i tokëzimit: [TNS]

    Specifikimet konstruktive të panelit

    Mbështjellësja:

    Shkalla e mbrojtjes IP: [55]

    Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK: [10]

    Ngjyra: standart RAL 9001

Dera: me bllokim me çeles

Gjëresia: 800 mm

Lartesia: 2000 mm

Thellesia: 300 mm

Hapesirë e llogaritur:

Hapësirë e lire 30 %

12. **Ndriçues Panel LED**, të vendosur në zyra, të jenë inkaso, forma rrethore dhe me aksesorë jashtë tavanit, 60x60cm, 40Ë, 3600 lm, 4000K, IP40.
    Ndriçues panel Led, të vendosur në tualete, forma rrethore, 20W, 2000 lm, 4000 K IP44.
    Ndriçues emergjence evakuimi me tregues dalje EXIT, LED 8W, me autonomi 3 orë, IP67 me bateri Ni-Cd.

***Shënim:*** *Autoriteti Kontraktor, për të gjitha këto specifikime teknike i është referuar projektit elektrik të godinës "Zyrat modulare për agjencitë doganore".*

## 10.1 SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA, NË AMBIENTET E JASHTME TË GODINËS.

Operatori ekonomik privat që do te kontraktohet do të mirëmbajë një sipërfaqe të gjelbër prej 287 $m^2$ me qëllim për ti dhënë një pamje sa më tërheqëse godinës së re që është investuar nga Autoriteti Portual Durrës, për akomodimin e agjencive doganore që ushtrojnë aktivitet tregtar në portin e Durrësit.

Konkretisht, shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit do të bëhet në të gjitha sipërfaqet e gjelbra përreth godinës, pra brenda murit rrethues të godinës, sipas fotos ilustruese më poshtë:



Operatori ekonomik privat që do te kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili do të përfshijë:

- Kositje/prerje e rregullt e gjithë sipërfaqes me bar, 2 (dy) herë në muaj (në kohën e duhur) dhe në raste të veçanta sipas nevojave që paraqet bari, i cili ndryshon në varësi të temperaturave dhe shpejtësisë së rritjes së tij gjatë vitit, me mjetet e duhura profesionale.
- Pastrimi nga barërat e këqija, të kryhet në varësi të përhapjes dhe shpejtësisë së rritjes së tyre.
- Krasitje e shkurreve me formë 2 (dy) herë në muaj (në kohën e duhur) dhe në raste të veçanta sipas nevojës, me mjetet e duhura profesionale.
- Sigurimi i nevojshëm i ujitjes/vaditjes së duhur për të gjitha zonat e gjelbërta, 2 (dy) herë në javë dhe në raste të veçanta sipas nevojës, proces i cili lidhet detyrimisht me rritjen, gjelbërimin, mostharjen e bimëve dhe shkurreve. Vaditja do të realizohet me markusha dore ose dhe me autobot uji.
- Plehërim kimik sipas stinës, në kohën e duhur dhe në sasinë e duhur, pasi plehërimi kimik është një proces tepër i rëndësishëm për rritjen e barit por nga Kontraktori duhet të hidhet në sasinë e duhur me shpërndarje në mënyrë uniforme me karrel dozator ose shpërndarje mekanike. Plehu të jetë i paketuar në thasë, të jetë cilësi e parë.
- Mbjellje dhe/ose zëvendësim i luleve dekorative sezonale në ambientet e jashtme, 2 (dy) herë në vit dhe në raste të veçanta sipas nevojave gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Lulet të jenë në gjendje të mirë dhe të padëmtuara.
- Sistemim dhe heqje mbeturinash nga krasitja dhe prerja e barit, shkurreve dhe transportimi i tyre në vendet e caktuara nga Pushteti Vendor.

Makineritë dhe mjetet, që duhen në funksion të këtij shërbimi/zëri, janë si më poshtë:

- Makinë kositëse bari ;
- Krëhër për pastrimin e sipërfaqes së gjelbër (barit);
- Gërshërë për krasitje;

Produktet e nevojshme që do të duhen për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta janë:

| **Emërtimi i produktit** | **Njësia** | **Sasia** |
|---|---|---|
| Pleh (Humus) | thasë | Sipas nevojës të A.K |
| Ushqyes për rigjenerimin e bimësisë | litër | Sipas nevojës të A.K |
| Preparat mbrojtës për lule dhe bimë | litër | Sipas nevojës të A.K |

**1. Plehu,** do të shërbejë për ndërrimin e domosdoshëm të plehut ekzistues në mënyrë që plehu të mos humbasë vlerat ushqyese. Plehu të jetë cilësi e parë.

**2. Ushqyesi**, të jetë në formë të lëngshme i cili do të ndihmojë në rigjenerimin e rrënjëzimit, zhvillimin e bimësisë, shkurreve dhe duhet të përdoret pas çdo vaditje, të jetë i paketuar në bidon, sasia mbi 1 litër.

**3. Preparat mbrojtës për lulet dhe bimësinë,** i cili ndihmon në parandalimin dhe rigjenerimin pas sëmundjes së luleve, bimëve , shkurreve. Të jetë në formë të lëngshme, i amblazhuar në bidon, sasia mbi 1 litër.

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta në ambientet e jashtme të godinës kërkohet nga Kontraktori prezenca e 1 (një) punëtori-kopshtar i pajisur me uniformën përkatëse.Kopshtari i vënë në dispozicion duhet të ketë të gjitha mjetet e punës të nevojshme për realizimin e shërbimit (makineri kositëse bari, gërshërë, krëhër, dorashka pune)

Të gjitha punimet si (plehërimi, ujitja, krasitja, kositja, mbjellja e barit etj) do të kryhen nga ora 08:00-16:00. Do të ketë përjashtime nga ky orar vetëm në raste të veçanta si psh: probleme emergjente, punë që kanë kohështrirje të gjatë etj.

**Kontraktuesi ka për detyrë:**

- OE është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta. Këto pajisje, makineri dhe vegla pune duhet që sipërmarrësi t'i sigurojë që me fillimin e punës dhe me mbarimin e kontratës t'i tërheqë ato. Të mos mungojë asnjë mjet i domosdoshëm gjatë realizimit të kontratës.
- Operatori i shërbimit do të sigurojë gjithashtu vetë edhe produktet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, si plehun, ushqyesin për rigjenerimin e bimësinë dhe preparatin për parandalimin e sëmundjes së bimësisë.
- Operatori i shërbimit duhet të vendosë tabela ndërgjegjësuese, në vendet e duhura për të ruajtur gjelbërimin.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim për të parë kryerjen e shërbimeve të sipërpërmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

**Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e kësaj kontrate, të lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Licensimit, për kategoritë e mëposhtme:

- **II.8.B "Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore" (dezinfektim)**

- **III.2.B "Për transportim, grumbullim, mbetjeve jo të rrezikshme"** me kode te mbetjeve sipas katalogut shqiptar te mbetjeve (20 01 01, 20 01 02, 20 01 08, 20 01 39, 20 01 99, 20 02, 20 03, 20 03 01, 20 03 04, 20 03 06, 20 03 99).
- **Leje Mjedisi me kod III.1.B** me ID "Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenjerët ose nga larjet e kontenjerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar pë jo më shumë se 7 ditë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër shërbimet për të cilat kërkohet licenca profesionale, sipas Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.1.2** Operatori ekonomik që do të realizojë këtë kontratë, për të vërtetuar se shërbimet objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO (të përkthyera në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Certifikatat përkatëse ISO janë:

- Çertifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit;
- Çertifikatë ISO 14001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit;
- Çertifikatë ISO 45001:2018 të standartit ndërkombëtar të Sistemi të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, secili operator

ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake të bashkëpunimit.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023,** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet**

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga këto autoritete. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë j**o më pak se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 8 (tetë) punonjës të specializuar/ të kualifikuar, në profilet sipas tabelës së mëposhtme:

| **Stafi** | **Nr.** |
|---|---|
| Përgjegjës për mirëmbajtjen | 1 (një) |
| Punonjës elektricist | 1 (një) |
| Punonjës hidraulik | 1 (një) |
| Punonjës shërbimi/Sanitar | 3 (tre) |

| | |
|---|---|
| Lulishtar/Kopështar | 1 (një) |
| Punonjës dezinfektimi, për operimin e pajisjeve dezinfektuese dhe/ose preparateve | 1 (një) |
| **Totali i punonjësve** | **8 (tetë)** |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, OE duhet të paraqesë:

**Për përgjegjësin për mirëmbajtjen të paraqitet**:

- Diplomë (shkolle e mesme elektrike/mekanike/hidraulike) ose Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontratë individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse si mirëmbajtës.

**Për punonjësin elektricist të paraqitet:**

- Diplomë (shkolle e mesme elektrike) ose Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
